



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**MEMORANDUM SHPJEGUES PËR PROJEKT
RREGULLORE PËR ORARIN E PUNËS DHE
PUSHIMET NË ADMINISTRATËN E
SISTEMIT GJYQËSOR**

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Kjo projekt rregullore ka për qëllim të përcaktojë kriteret dhe rregullat për caktimin e orarit të punës dhe të pushimeve si dhe procedurën për shfrytëzimin e pushimeve të nëpunësve në administratën e sistemit gjyqësor.

Përmes kësaj projekt rregullore synohet që dispozitat e saj të jenë të zbatueshme për të gjithë nëpunësit në administratën e sistemit gjyqësor.

Me këtë projekt rregullore përcaktohet orari i punës, orari fleksibil, orari jo i plotë i punës, i shkurtuar, puna jashtë orarit, pushimi vjetor, shfrytëzimi i pushimit vjetor në administratën e sistemit gjyqësor.

Projekt rregullorja gjithashtu e parasheh edhe shfrytëzimin e pushimit vjetor në administratën e sistemit gjyqësor (në bllok), duke specifikuar edhe dy periudhat kohore mbi të cilat mund të bëhet shfrytëzimi i pushimit vjetor.

Tutje, projekt rregullorja përfshinë edhe pushimin mjekësor, pushimin e lehonisë,

	<p>mungesën në punës me pagesë dhe pushimin pa pagesë për nëpunësit e administratës së sistemit gjyqësor.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Hartimi i Projekt Rregullore për Orarin e Punës dhe Pushimet në Administratën e Sistemit Gjyqësor ka rëndësi për disa arsye:</p> <p>Së pari, kjo projekt rregullore është e rëndësishme për të përcaktuar orarin e punës dhe pushimet në një mënyrë të drejtë, duke ndihmuar në sigurimin e një ambienti të shëndetshëm dhe të drejtë për punonjësit.</p> <p>Së dyti, kjo projekt rregullore ka ardhur si rezultat i ndryshimeve ligjore, veçanërisht me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik, sipas të cilit kërkohet një rregullim i veçantë për orarin e punës dhe pushimet e nëpunësve në administratën e sistemit gjyqësor.</p> <p>Së treti, kjo projekt rregullore parashikon edhe mundësinë e reduktimit të orëve të punës për nëpunësit e administratës së sistemit gjyqësor në punët me shkallë të lartë të rrezikshmërisë, të cilat mund të kenë ndikim negativ në shëndetin e punonjësve.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të projekt Rregullore për orarin e punës dhe pushimet në administratën e sistemit gjyqësor.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo</p>

	<p>sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 19 prill 2024.</p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft rregullore, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>